FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

BRONAX

Shurup - 4 mg / 5 ml

(Bromheksinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Bronax dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Bronax
3. Si ta merrni Bronax
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Bronax
6. Informacion i mëtejshëm.

1. ÇFARË ËSHTË BRONAX DHE PËRSE PËRDORET

Bronax përmban lëndën vepruese bromheksinë klorhidrat, e cila është një bar mukolitik që përdoret për mjekimin e çrregullimeve të frymëmarrjes kur ato shoqërohen me mukus viskoz ose të tepërt. Ajo ndihmon në jashtëqitjen e sekrecioneve trakeobronkiale dhe në uljen e viskozitetit të këtyre sekrecioneve, çka shpie në përmirësimin e frymëmarrjes.

Bronax përdoret për:

- ➢ lëngëzimin e sekrecioneve të rrugëve të frymëmarrjes në rastet e sëmundjeve bronkopulmonare akute e kronike, si: bronkit, emfizemë, trakeobronkit dhe bronkit astmatik kronik;
- ➢ parandalimin e ndërlikimeve të frymëmarrjes pas ndërhyrjeve kirurgjikale në kraharor;
- ➢ të shpejtuar ekspektorimin e lëndëve të huaja endobronkiale (mjete kontrasti të radiologjisë).

Gjatë përkeqësimit të bronkitit akut, shurupi duhet përdorur me një antibiotik të përshtatshëm.
Mjeku juaj mund t'ju ketë dhënë Bronax për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun nëse doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI BRONAX

Mos merrni Bronax në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj bromheksinës ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të shurupit;
- vuani nga ulçera gastroduodenale aktive;
- keni çrregullime të rënda të funksionit të mëlçisë.

Nuk duhet të përdoret në fëmijë nën 2 vjeç.

Tregoni kujdes të veçantë me Bronax

Pyesni mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni Bronax!

Bromheksina duhet përdorur me kujdes të veçantë në tuberkulozin aktiv.
Duhet treguar kujdes nëse bromheksina përdoret tek pacientët astmatikë.
Këshillohet që ky bar të mos përdoret gjatë shtatzënisë, veçanërisht në tremujorin e parë, dhe gjatë ushqyerjes së fëmijës me gji.
Janë raportuar reaksione të rënda në lëkurë për shkak të përdorimit të bromheksinës.
Nëse ju shfaqet rash në lëkurë (përfshirë dëmtime të membranave mukoze si: në gojë, grykë, hundë, sy, organe gjenitale), ndërpriteni përdorimin e Bronax dhe njoftoni mjekun menjëherë.
Në disa raste, përdorimi i bromheksinës mund të shkaktojë një rritje të vëllimit të sekrecioneve bronkiale të lëngëzuara dhe këto nuk jashtëqiten me kollitje, kështu që parapëlqehet që i sëmuri të intubohet, me qëllim që të mbahen të lira rrugët e frymëmarrjes.
Klirensi i bromheksinës ose i metabolitëve të saj mund të reduktohet tek pacientët me dëmtime të rënda hepatike ose renale.
Meqenëse bromheksina dëmton mukozën gastrike, duhet përdorur me kujdes tek pacientët që kanë histori të ulçerës peptike.

Marrja e barnave të tjera

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë.
Bronax nuk duhet përdorur bashkë me barnat kundër kollës (veçanërisht me kodeinën) ose me barnat që ushtrojnë veprim të ngjashëm me atropinën.
Përdorimi i njëkohshëm i Bronax me disa antibiotikë (si p.sh. ampicilinë, amoksicilinë, eritromicinë ose oksitetraciklinë), rrit përqëndrimin e antibiotikut në sekrecionet bronkiale.

Marrja e Bronax me ushqim dhe pije

Nuk njihen raste të ndërveprimit. Mund të merret para ose pas ushqimit.

Shtatzënia

Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit përpara se të merrni këtë bar!

Bromheksina e kalon placentën në sasi të vogla.
Këshillohet të evitohet përdorimi gjatë tremujorit të parë të shtatzënisë, por edhe në muajt e tjerë nuk rekomandohet dhe duhet vepruar gjithmonë sipas këshillës së mjekut.
Para përdorimit të këtij bari bëjini të ditur mjekut tuaj nëse jeni shtatzënë ose nëse planifikoni një shtatzëni.

Ushqimi me gji

Bromheksina kalon në qumështin e gjirit.
Nuk ka informacion në lidhje me sigurinë, prandaj duhet të evitohet përdorimi.
Në qoftë se është e domosdoshme që bari të merret nga nëna gjatë ushqimit me gji, ky i fundit duhet të ndërpritet.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Bronax

Bronax përmban:

- sorbitol; nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar;
- sukrozë; nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë ndaj disa sheqernave, kontaktoni mjekun përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI BRONAX

Gjithmonë merreni Bronax sipas këshillës së mjekut ose farmacistit. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Bronax janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Klorhidrati i bromheksinës merret kryesisht në doza
4 – 16 mg tre herë në ditë.
2 – 5 vjeç: 2.5 ml (1/2 lugë çaji), 3 herë në ditë.
6 – 12 vjeç: 5 ml (1 lugë çaji), 3 herë në ditë.
Fëmijët mbi 12 vjeç dhe të rriturit: 10 ml (2 lugë çaji), 3 herë në ditë.
Për të rriturit, në fillim të mjekimit, mund të lindë nevoja e rritjes së dozës së përgjithshme ditore deri në 4 lugë gjelle shurup (60 ml; 48 mg).
Bromheksina nuk duhet të përdoret në fëmijët nën 2 vjeç.

Në qoftë se keni marrë më shumë Bronax

Në qoftë se keni marrë më shumë Bronax se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Bronax

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, bromheksinë mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Në përgjithësi bromheksina tolerohet mirë.
Në personat e ndjeshëm mund të shfaqen çrregullime gastrointestinale, të cilat përgjithësisht janë të lehta.
Në disa raste është konstatuar një rritje e vlerave të aminotransferazës në serum.
Janë raportuar edhe efekte të tjera të padëshirueshme, si: dhimbje koke, marrje mendsh, djersitje dhe rashe në lëkurë.
<u>Të rralla: mund të shfaqen në 1 ndër 1,000 pacientë</u>
Reaksione mbindjeshmërie, rash, urtikarie
<u>Të panjohura: frekuenca nuk mund të përcaktohet nga të dhënat që disponohen</u>
Reaksione anafilaktike përfshirë: shok anafilaktik, angioedema (enjtje e shpejtë e lëkurës, nënlëkurës, mukozës ose indeve nënmukozale) dhe prurit.
Reaksione të rënda në lëkurë (përfshirë eritemë multiforme, sindrom Stivens – Xhonson / nekrolizë epidermale toksike dhe pustulozë ekzantematoze akute, e gjeneralizuar).
Ndërpriteni menjëherë mjekimin dhe njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ju shfaqen reaksione alergjike ose reaksione në lëkurë.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI BRONAX

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Bronax pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim!
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Bronax - shurup

Lënda vepruese është bromheksinë klorhidrat.
5 ml shurup përmbajnë 4 mg bromheksinë klorhidrat.
Përbërësit e tjerë janë: acid tartrik, acid benzoik, glicerinë, sorbitol 70%, sukrozë, hidroksid natriumi, esencë banane, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me një shishe qelqi të errët 100 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Mund të merret pa recetën e mjekut.

Përmbajtja. Kujdes. Shurup.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00 355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Prill 2013.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.